



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 422 prot.

Tiranë, më 17.04.2019

**VENDIM**

**Nr. 25, datë 17.04.2019**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 5, DATË 16.01.2019**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 5, datë 16.01.2019, “Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me shkresën nr. 840/2 prot., datë 21.11.2018”,

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet informacionit me nr. 840 prot., datë 05.11.2018, nëpunësja \*\*\*\*\* , ka parashtruar përpara Komisionerit disa pretendime për parregullsi lidhur me dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, dhënë nga Dega Doganore Tiranë.

Për të sqaruar rrethanat e rastit, Komisioneri, me shkresën nr. 840/2 prot., datë 21.11.2018, ka nisur fillimin e verifikimit të këtij informacioni. Në përfundim të hetimit administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin Nr. 5, datë 16.01.2019, “Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me shkresën nr. 840/2 prot., datë 21.11.2018”, në të cilin është vendosur:

“1. Organi publik, drejtuesi i Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktitnr. 1220/3 prot., datë 24.10.2018, të Drejtuesit të Degës Doganore Tiranë, me anë të të cilit materializohet dhënia e masës disiplinore “vërejtje”, ndaj nëpunëses \*\*\*\*\* dhe mbi këtë bazë të anulojë aktin e mësipërm.

2. Të hiqet akti i mësipërm i masës disiplinore nga dosja e personelit të nëpunëses \*\*\*\*\* dhe të fshihen shënimet e bëra.”

Në vijim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me shkresënr. 1477/1 prot., datë 28.01.2019, “Urdhër” me objekt: “Shpallje akti administrative absolutisht të pavlefshëm”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 66/5 prot., datë 30.01.2019, ka vënë në dijeni këtë të fundit, në lidhje me masat e marra, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në dispozitivin e Vendimit Nr. 5, datë 16.01.2019, “Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë së procesit të dhënies së masës disiplinore “Vërejtje”, prej eprorit direkt, Kryetarit të Degës së Doganës Tiranë, ndaj nëpunëses \*\*\*\*\*”, “Doganier në Sektorin e Vlerës në Qendër”, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, në Degën Doganore, Tiranë”.

Në analizë të të gjithë praktikës shkresore të këtij rasti, vërej se:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me Urdhërn. 1477/1 prot., datë 28.01.2019, me objekt: “Shpallje akti administrative absolutisht të pavlefshëm”, në mbështetje të nenit 108, germa a), pika ii) dhe germa ç), nenit 110 dhe 111 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, dhe në zbatim të Vendimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me Nr. 5, datë 16.01.2019, ka konstatuar si absolutisht të pavlefshëm aktin nr. 12220/3 prot., datë 24.10.2018, “Dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, të Degës Doganore Tiranë, për nëpunësin civil \*\*\*\*\*”, aktualisht me detyrë Specialiste, Sektori i Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore, Drejtoria e Politikave të Vlerësimit Doganor.

Në pikën 3 të këtij Urdhri, Drejtori i Përgjithshëm i Doganës ka urdhëruar Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për heqjen e masës disiplinore “Vërejtje”, nga Regjistri Qendrori Personelit (HRMIS) dhe nga dosja e personelit të nëpunësit \*\*\*\*\*.

Për sa u parashtua më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave janë zbatuar rekomandimet e lëna në Vendimin Nr. 5, datë 16.01.2019, “Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë së procesit të dhënies së masës disiplinore “Vërejtje”, prej eprorit direkt, Kryetarit të Degës së Doganës Tiranë, ndaj nëpunëses \*\*\*\*\*”, “Doganier në Sektorin e Vlerës në Qendër”, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, në Degën Doganore, Tiranë”, të Komisionerit.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 5, datë 16.01.2019, “Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë së procesit të dhënies së masës disiplinore “Vërejtje”, prej eprorit direkt, Kryetarit të Degës së Doganës Tiranë, ndaj

*në punëses \*\*\*\*\**, “*Doganier në Sektorin e Vlerës në Qendër*”, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, në Degën Doganore, Tiranë”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit të inspektuar Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 5, datë 16.01.2019.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**

Konceptoi: *L. Zhapa*  
Miratoi: *E.Hebibasi*